

GMS QUICK LINK SHPK

STATUT

dhe

AKT THEMELIMI

Dokument ligjor
[06.08.2024]

STATUTI AKT THEMELIMI
i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“GMS QUICK LINK” sh.p.k.

Sot me datë **06/08/2024** në bazë të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Q.K.R” dhe të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare” me vullnetin e lirë ortakët stipulojnë dhe nëshkruajnë këtë statut e akt themelimi si vijon:

PJESA E PARË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Forma ligjore e shoqërisë

- Shoqëria shpk e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozita të parashikuara në dokumentet e krijimit të saj (statutit).
- Ky Statut është përpiluar në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.
- Shoqëria **GMS QUICK LINK** shpk është person juridik.

Neni 2

Kohëzgjatja

- Shoqëria shpk krijohet për të ushtruar veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje **pa afat**.

Neni 3


Emërtimi i shoqërisë

- Emri i shoqërisë është **“GMS QUICK LINK” sh.p.k**, (më poshtë referuar si “Shoqëria”).
- Emri tregtar i shoqërisë është **“GMS QUICK LINK”**. Shoqëria ka vulën e saj ku specifikohet emri dhe nipti i shoqërisë.

Neni 4

Objekti i aktivitetit


Shoqëria shpk do të ketë si objekt: *delivery ushqimore - postare etj, restorant bar, blerje kuotash të shoqërive tregtare shqiptare dhe të huaja, marrje në menaxhim të aktiviteteve të ndryshme tregtare në Shqipëri dhe në shtete të huaja të tjera, pjesëmarrje në aktivitete tregtare nëpërmjet marrëveshjeve dhe/ose*



ndërhyrjeve në blerje të pjesshme ose të plota të kuotave të aksioneve e shoqerive tregtare në shqiperi dhe jashte. Tregti shit-blerje produktesh ushqimore me pakicë dhe shumicë, import-eksport i të gjitha produkteve ushqimore dhe jo vetëm. Import-eksport dhe tregtimin e të gjitha llojeve të materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve të ndryshme të karakterit elektrik, elektroshtëpiak, elektronik, të telekomunikacionit, të destinuara për objekte civile dhe industriale. Prodhimin e pajisjeve dhe makinerive të përmendura më sipër. Blerje dhe shitje pasuri të paluajtshme, qiradhënia e pasurive të paluajtshme të veta apo si aktivitet ndërmjetësimi për të tretë si Agjenci imobiliare, zhvillim pronash; Menaxhimi I pasurive të paluajtshme me pagesë ose kontratë; Realizimi I investimeve në pasuri imobiliare më vete dhe si pjesë e joint-venture; Kryerjen e veprimtarive të shërbimit e riparimit të karakterit, elektrik elektronik të telekomunikacionit e të llojeve të tjera. Projektimin dhe zbatimin e projekteve, dhënien e konsulencës, asistencës teknike dhe kryerjen e shërbimeve në lidhje me veprimtaritë e mësipërme. Ofrimi I rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike. Montim-Prodhim panele dhe pajisje elektrike, elektronike, për përdorim civil dhe industrial, projektim I tyre, importe-eksport I tyre. Projektim dhe Instalim I impianteve teknologjike, termike, hidrike, të ventilimit ftohje- ngrohjes (kondicionimit), furnizimit me gaz, I impianteve ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues), të sinjalistikës rrugore. Shërbime mirëmbajtje dhe servisi të ndryshme për materiale e pajisje elektrike, pajisje industriale e elektroshtëpiake si dhe për pajisje dhe sisteme të kondicionimit si dhe për impiantet e tjera të çfarëdo lloji në vendet e ushtrimit të aktivitetit dhe jashtë tyre në objekte të ndryshme. Shërbime konsulence, mbikqyrje dhe kolaudimi lidhur me materialet elektrike, pajisjet industriale e elektroshtëpiake dhe supervizionin ne lidhje me instalimin e tyre. Studime fizibiliteti në fushen e ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë. Kryerjen e veprimtarisë në fushën e ndërtimit, studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të veprave me karakter shfrytëzimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private. Menaxhim i terreneve sportive, bar-restorant, hoteleri, turizëm e agroturizëm. Konsulencë financiare dhe juridike, aktivitete ndërmjetësimi, përfaqësimi, përkthimi, administrimi, angazhimi dhe promovimi të personave juridikë dhe fizikë të kategorive të ndryshme që shërbejnë në fusha të ngjashme, drejtëpërdrejtë apo me nënkontraktor Brenda territorit shqiptar ose jashtë tij. Agjenci e shërbime të transportit të pasagjerëve e të mallrave, taksi, shërbime urbane e interurbane, transpedicion si dhe çdo operacion tjetër që bashkohet me veprimtaritë e mësipërme e që konsiderohet I përshtatshëm për rritjen e zhvillimin e mëtejshme të aktivitetit të shoqërisë. Agjenci udhëtimi. Projektim, zhvillim, kompletim me pajisje dhe ofrim të instruktazhit për impiante dhe shërbime të ndryshme. Punime ndërtimi. Çdo aktivitet mbështetës apo plotësues I pacituar shprehimisht mësipër, por në lidhje me sa më sipër.



Shafiq



Listimi i mësipërm nuk e pengon shoqërinë nga zhvillimi i çdo lloj aktiviteti të lejuar nga ligji me një regjistrim të thjeshtë në organet përkatëse të regjistrimit.

Neni 5 Selia e Shoqërisë




- Selia e Shoqërisë është në adresën: **Bashkia Tiranë, Rruga Komuna e Parisit, zona kadastrale 8270, numër pasurie 8/883-N20**. Shoqëria mund të hapë degë, përfaqësi, zyra dhe njësi në çdo vend brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe do të zbatojë procedurat përkatëse ligjore dhe të regjistrimit. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- Asambleja e Ortakëve mund të vendosë, hapjen e filialeve, selive dytësore, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë, dhe jashtë shtetit. Asambleja e Ortakëve mund t'ia delegojë këtë kompetencë organit administrativ.

Neni 6 Kapitali themeltar

- Kapitali Themeltar i shoqërisë shpk është 100 000 lekë i ndarë në 3 kuota. Ky kapital themeltar zotërohet nga ortakët si më poshtë:
 1. Ergusejda Mici, shtetase shqiptare, me numër personal I85630094N.
 2. Georgios-Marios Vasileiou, shtetas grek, me numër personal AN578637.
 3. Shafaqat Ali, shtetas pakistanez, me numër personal 34201-0385385-1.

Nr.	Emri Mbiemri	Numri personal	Kuota %	Vlera monetare LEK
1	Ergusejda Mici	I85630094N	30%	30 000
2	Georgios-Marios Vasileiou	AN578637	35%	35 000
3	Shafaqat Ali	34201-0385385-1	35%	35 000

- Kapitali nuk mund të jetë i përfaqësuar në letra me vlerë apo i premtuar **por i paguar**.
- Shoqëria mund të hapë numra llogarie bankare jo vetëm në monedhën funksionale vendase - lek por edhe në çdo lloj valute tjetër. Administratori në çdo rast depoziton specimenin e firmës së tyre në çdo rast.
- Kapitali themeltar ose pjesë të caktuara të tij e janë lehtësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të kodit civil dhe atij tregtar.

- Asambleja e Ortakut të Vetëm të Kapitalit ka të drejtë ekskluzive të transferojë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht ose tërësisht kontributet e saj, qofshin ato në para ose në natyrë. Transferimi i kapitalit ose pjesëve të tyre në favor të një personi të tretë bëhet gjithmonë me miratim të ortakut/ëve. Shoqëria dhe të tretët detyrohen të respektojnë këto transferime sapo ato t'iu komunikohen.
- Vlerësimi i kapitalit themeltar në natyrë bëhet nga ortakët në një marrëveshje të vecantë ose një nga ekspertët kompetentë i caktuar nga ortakët.
- Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar bëhet me vendime të shkruara të asamblesë së ortakëve. Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen në një regjistër të veçantë.
- Shoqëria "GMS QUICK LINK" shpk për detyrimet që do të lindin gjatë aktivitetit me të tretët, përgjigjet vetëm me pasurinë e saj. Ortakët e shoqërisë nuk përgjigjen për detyrimet e kësaj shoqërie me pasurinë e tyre që nuk është futur në kapitalin e shoqërisë. Pjesëmarrja me këtë shoqëri nuk pengon ortakët të kenë pavarësi ligjore, organizative dhe të drejta pronësie jashtë kësaj shoqërie.
- Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- Çdo ndryshim i bërë në kapitalin e shoqërisë ka vlerë ligjore pas depozitimit të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit sipas dispozitave ligjore në fuqi.



PJESA E DYTË

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQËRISË

Neni 7 Asambleja e ortakëve

- Organi më i lartë vendimor i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Në asamble marrin pjesë të gjithë ortakët me të drejtë vote sipas shumave të vëna në kapitalin themeltar të shoqërisë. Asambleja mund t'ia delegojë kompetencat një ose disa administratorëve brenda shoqërisë ose një shoqërie apo personi të tretë, gjithmonë nëpërmjet prokurës noteriale.
- Autorizimi apo prokura e posaçme që do të bëhet tregon mbledhjen e ortakëve, vendin, rendin e ditës dhe nuk ka vlerë më shumë se në një mbledhje ortakësh. Asnjë prokurë nuk ka vlerë ligjore nëse nuk përcakton rendin e ditës në mbledhjen e ortakëve.

Asambleja e ortakëve kryen këto funksione:

- Përcakton politikat tregtare të shoqërisë
- Emëron dhe revokon Administratorin e shoqërisë.
- Kryen modifikime në statutin e shoqërisë pas ecurive të shoqërisë si dhe kontroll të shoqërisë.
- Vendos për hapjen e filialeve, degëve apo zyrave të përfaqësimit jashtë vendit.
- Vendos për ndryshime në objektin e veprimtarisë kryesore të shoqërisë.
- Vendos për shtimin, pakësimin ose transferimin e kapitalit themelor.
- Vendos mbi emërtimin dhe revokimin e likuidatorëve/it.
- Miraton Pasqyrat Financiare vjetore të shoqërisë dhe Raportet e Ecurisë.
- Emëron dhe revokon Ekspertin kontabël të Shoqërisë.
- Vendos mbi veprime financiare për blerje pjesëmarrjesh në shoqëri të tjera
- Vendos për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë ose shndërrimin e saj me një tip tjetër shoqërie.
- Vendos për çdo çështje tjetër jo të specifikuar më lart por që ndikon në kapitalin e saj dhe që parashikohet nga legjislacioni.
- Vendimarrja e zakonshme e shoqërisë kërkon 75% të votave totale të kompanisë.

Neni 8

Të drejtat e ortakëve

Ortakët kanë të drejta kryesore të cilat ushtrohen nëpërmjet vendimeve të marra nga Asambleja e Ortakëve.


Të marrin pjesë në administrimin e veprimtarive ekonomike-tregtare të shoqërisë, në përputhje me kontratën dhe statusin.

- Të kërkojnë dhe t'u jepen të dhëna që kanë të bëjnë me gjendjen dhe veprimtarinë e shoqërisë si dhe të gjitha dokumentat e përpunuara nga shoqëria (bilanci, libra llogarie).
- Të vendosin mbi fitimin/humbjen e vitit ushtrimor.
- Të bëjnë propozime dhe t'i paraqesin ato me shkrim para administratorit dhe Asamblesë së Shoqërisë.
- Të heqin dorë nga shoqëria në kushtet që përcaktohen në kontratë dhe në këtë statut.
- Të kërkojnë likuiditet kundrejt kompanisë ku zotërojnë shumicën ose krejtësisht kapitalin pa patur nevojë të mblidhen për vendimarrje sa herë që këto transferime likuiditeti të jenë të nevojshme. Në çdo rast kjo të shënohet në librat kontabël të kompanive respektive.

Neni 9

Detyrimet e ortakëve



Ortakët kanë këto detyra kryesore:


- Të depozitojnë kuotën e tyre ose kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe me vendimet e Asamblesë (për fondin rezervë).
- Të marrin pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga ata vetë.
- Të respektojnë detyrimet e caktuara nga Asambleja ose nga Administratori për realizimin e detyrave të shoqërisë.
- Të shtojnë likuiditet kundrejt kompanisë ku zotërojnë shumicën ose krejtësisht kapitalin pa patur nevojë të mblidhen për vendimmarrje sa herë që këto transferime likuiditeti të jenë të nevojshme. Në çdo rast kjo të shënohet në librat kontabël të kompanive respektive.

Neni 10 Administratori

- Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- Administratori i shoqërisë përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët dhe ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër dhe për llogari të shoqërisë.
- Shoqëria merr përsipër të gjitha përgjegjësitë që mund të vijë nga veprimet e kryera nga administratori. **Administratorët si vijon, kanë të drejtë ta përfaqësojnë shoqërinë në mënyrë të pavarur:**

Nr.	Emri Mbiemri	Numri personal	Afati i emërimit	Specimeni i firmës
1	Ergusejda Mici	I85630094N	06.08.2024- 06.08.2029	
2	Georgios-Marios Vasileiou	AN578637	06.08.2024- 06.08.2029	

- Afati i mandatit të administratorit/ëve është 06/08/2024 deri 06/08/2029, me të drejtë rinovimi.
- Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.
- Administratori është përgjegjës individualisht ose solidarisht ndaj shoqërisë ose ndaj personave të tretë, kur gjatë veprimeve të tyre shkelin ligjin, kontratën dhe statutin, si dhe shkeljet e kryera nga ai gjatë administrimit të shoqërisë.

PJESA E TRETË MARRËDHËNIET EKONOMIKE-FINANCIARE

Neni 11
Viti financiar

- Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".
- Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.
- Miratimi kërkon 75% të kuotave të ortakëve.

Neni 12
Fitimet e vitit ushtrimor

- Fitimet neto i realizuar nga aktiviteti i shoqërisë do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcion me kuotat e tyre takuese në kapitalin themeltar. Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të leverdisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancin e saj. Bilanci i aktivitetit të shoqërisë përgatitet në fund të vitit e duhet të dorëzohet brenda muajit mars të vitit që vijon.
- Bilanci i aktivitetit financiar mund të bëhet nga vetë ortakët ose nga ekspertët e caktuar prej tyre. Por në të gjitha rastet, rezultatet e bilancit financiar duhet të aprovohen nga Asambleja e ortakëve brenda 6 muajve pas mbylljes së vitit financiar.
- Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, me vendim Asambleje, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- Asambleja mund të vendosë zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.
- Miratimi i kësaj vendimmarrje kërkon 75% të kuotave të ortakëve.


Neni 13
Rezervat e kapitalit

- Shoqëria krijon fondet e saj për zhvillimin e zgjerimin e aktivitetit.
- Rezervat statutore e ligjore të jenë në masën e caktuar sipas legjislacionit në fuqi.
- Përbërja e fondeve, burimet financiare të tyre, caktohen nga asambleja e ortakëve.
- Shoqëria i disponon plotësisht mjetet e saj financiare.

PJESA E KATËRT

MBYLLJA E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË

Neni 14
Mbyllja e aktivitetit



- Veprimtaria e shoqërisë pushon/përfundon në qoftë se ortakët me vullnetin e tyre të lirë e vendosin këtë. Për pushimin e veprimtarisë kërkohet unanimitet.

Neni 15
Likuidimi i shoqërisë

- Shoqëria mund te prishet në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi unanim të Asamblesë së Ortakëve. Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.
- Kur shoqëria likujdohet plotësisht, Asambleja krijon komisionin e likuidimit në të cilin paraqet bilancin e likuidimit.
- Pasuria e shoqërisë, pasi shlyhen detyrimet e shoqërisë, do të ndahet mes ortakëve në proporcion me kontributin e tyre në kapitalin themeltar.
- Pasuria që është futur në shoqëri me të drejtë shfrytëzimi i kthehet pronarit të saj.




Të dhëna të tjera të shoqërisë:

Email: maria.mici.88@gmail.com

Numër telefoni: 0692081588

Ky akt është përpiluar në përputhje të plotë me vullnetin e lire dhe të plotë të nënshkruesve të tij.

ORTAKËT E SHOQËRISË

1. Ergusejda Mici 
2. Georgios-Marios Vasileiou ΓΙΟΡΓΙΟΣ ΜΑΡΙΟΣ ΒΑΣΙΛΕΙΟΥ 
3. Shafaqat Ali SHAFAGAT ALI 

06 Gusht 2024